

GARANTIMI I CILËSISË NË ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL – SHQIPËRI

Institucioni Anëtar i Forumit të ETF:
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional
dhe Kualifikimeve

Qershor 2020



Quality Assurance Forum

FORUMI I FONDACIONIT EVROPIAN TË TRAJNIMIT (ETF) PËR
SIGURIMIN E CILËSISË NË ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL

Permajtja e ketij raporti eshte kendveshtrimi i ETF dhe nuk pasqyrojne domosdoshmerisht kendveshtrimin e institucioneve te Bashkimit European.

© Fondacioni Evropian i Trainimit, 2020

Autorizohet ri-prodhimi, atëherë kur citohet burimi.

PËRMBAJTJE

1.	PREZANTIM	4
1.1	Konteksti kombëtar	4
1.2	Statistikat	4
1.3	Sistemi i AFP-së	5
2.	GARANTIMI I CILËSISË NË AFP	7
2.1	Pamje e përgjithshme	7
2.2	Informacion i përgjithshëm mbi garantimin e cilësisë në nivel sistemi të AFP-së	7
2.3	Garantimi i cilësisë në lidhje me fushat kyçe të AFP-së	7
3.	ZHVILLIMET, NEVOJAT EMERGJENTE DHE SFIDAT	9
4.	SHEMBULL I PRAKTIKAVE TË MIRA	10

1. PREZANTIM

1.1 Konteksti kombëtar

Shqipëria është një vend me të ardhura mbi mesataren me një popullsi prej 2,88 milionë banorë. Ekonomia vazhdon të zgjerohet, e nxitur nga një mjedis i favorshëm i brendshëm dhe i jashtëm. PBB-ja reale arriti 3,8% në vitin 2017, duke reflektuar një rritje në investimet kapitale, por edhe rritje në konsumin privat.

Treguesit e tregut të punës janë përmirësuar gjatë viteve të fundit. Norma e pjesëmarrjes në forcën e punës (të rriturit e moshës 20 deri 64 vjeçare) u rrit në 73,9% në vitin 2017 dhe papunësia është në tendencë rënëse, duke u ulur nga një maksimum prej 17,5% në vitin 2014 në 13,7% në vitin 2017.

1.2 Statistikat

TABELA 1. POPULLSIA

	Madhësia e popullsisë	Madhësia relative e popullsisë së re (15–24, %)
2010	2 918 674	22,0
2014	2 892 394	25,8
2018	2 870 324	23,7

Burimi: Instituti i Statistikave i Shqipërisë (INSTAT)

TABELA 2. PUNËSIMI

	Norma e punësimit (në total, %)	Norma e punësimit te të rinjtë (15–24, %)
2010	60,3	23,4
2014	56,6	17,7
2018	63,9	25,7

Burimi: INSTAT

TABELA 3. NIVELI ARSIMOR I POPULLATËS AKTIVE (%)

	Largimi i hershëm nga shkolla (18–24)	I ulët	Mesatar	I lartë
2010	31,9	51,6	35,9	12,5
2014	26,0	45,6	37,1	17,3
2018	19,6	43,2	36,8	20,0

Shënim: I ulët – Klasifikimi i Standardit Ndërkombëtar të Arsimit (KSNA) 0–2; I mesëm – KSNA 3–4; I lartë – KSNA 5–8.

TABELA 4. PJESEMARRJA NË AFP (PËRQINDJA E GRUPMOSHËS SË PËRGJITHSHME NË ARSIM DHE TRAJNIM)

	AFP, cikli i mesëm (KSNA 3)
2010	9,1
2015	16,4
2018	18,2

Burimi: Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve; Ministria e Financës dhe e Ekonomisë

TABELA 5. SHPENZIMET PËR ARSIMIN E PËRGJITHSHËM

	2010	2014	2018
% e PBB-së	3,4	3,3	3,2
% e shpenzimeve totale publike	13,0	10,5	10,9

Burimi: Ministria e Ekonomisë dhe e Financave

1.3 Sistemi i AFP-së

AFP-ja fillon pas përfundimit të shkollimit të detyrueshëm nëntëvjeçar. Shkollat profesionale ofrojnë arsim formal profesional. Por, pak prej këtyre shkollave janë të përziera, pra që ofrojnë si arsim të përgjithshëm (të njohur si gjimnaze) dhe drejtime të AFP-së në nivelin e ciklit të mesëm. Si gjimnazet formale ashtu edhe programet katërvjeçare të AFP-së çojnë në provimet e maturës shtetërore, përfundimi i suksesshëm i së cilës jep qasje në arsimin e lartë dhe/ose arsimin pas të mesëm.

Programet e AFP-së ofrojnë pika daljeje pas dy, tre ose katër vjetësh (në varësi të programit). Pas përfundimit, të diplomuarit marrin një certifikatë të maturës shtetërore profesionale (nëse aplikohet, KSNA dhe KSHK niveli 4), si edhe certifikatë profesionale për programin përkatës të AFP-së (zakonisht KSNA 3 dhe KSHK niveli 2, 3 ose 4).

Drejtimi dhe menaxhimi

Ministria e Financës dhe e Ekonomisë (MFE) aktualisht është përgjegjëse për politikëbërjen, kuadrin ligjor dhe të gjitha aspektet e financimit, rekrutimit të drejtuesve etj. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe e Aftësive është përgjegjëse për menaxhimin e ofruesve të AFP-së. Nuk ka asnjë strukturë administrative për AFP-në në nivele rajonale.

Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve është përgjegjëse për implementimin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), që përfshin një klasifikim profesionesh, katalog kualifikimesh profesionale me standardet përkatëse; kurrikulat kombëtare për të gjitha programet e AFP-së të ofruara në sistemin formal të arsimit profesional; mbështetjen për zhvillimin e kurseve të unifikuara në Qendrat e Formimit Profesional (QFP); certifikimin dhe vete-vlerësimin dhe akreditimin e ofruesve të AFP-së, si dhe administrimin e zhvillimit profesional dhe (VZHP) për mësuesit dhe instruktorët.

Pas një udhëzimi të kryeministrit, u krijua një organ ndër-institucional tripartiak i njohur si Grupi i Integruar i Menaxhimit të Politikave. Grupi përfshin sektorin e punësimit dhe aftësive. Megjithatë, ai mbledhet rrallë.

Financimi

Buxheti shtetëror është burimi kryesor i financimeve për shkollat publike profesionale dhe kostot bazë të personelit në QFP, si p.sh. pagat e drejtorit dhe disa pjesëtarë të stafit me kohë të plotë. Gjithashtu, financimi i shkollës bazohet në tendencat historike dhe merr në konsideratë numrin e personelit të punësuar dhe nxënësve të regjistruar, por jo gjithmonë kostot reale të ndonjë programi specifik të AFP-së.

Kuadri rregullator

Sistemi i AFP-së rregullohet kryesisht nga Ligji 15/2017 “Mbi arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, megjithëse disa akte nënligjore ende nuk janë miratuar, në veçanti ato që lidhen me njohjen e mësimit të mëparshëm.

Gjithashtu, Parlamenti Shqiptar miratoi ligjin e amenduar mbi Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve, në vitin 2018. Ligji përcakton objektivat e KSHK-së, funksionet dhe fushat, organin e saj qeverisës, nivelet e saj dhe llojet e kualifikimeve, si dhe përafrimin e saj me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve.

Llojet kryesore të institucioneve ofruese

AFP-ja ofrohet si në institucione publike dhe jo publike. Sipas përcaktimeve të kryera nga MFE në vitet 2019–20, ekzistojnë 890 institucione të AFP-së, të cilat përbëhen nga 45 organizata publike dhe 845 jopublike.

Gjatë vitit akademik 2018/19, të dhënat administrative të ofruara nga MFE tregojnë se në programet e arsimit profesional ishin regjistruar 18 192 nxënës. Megjithë përmirësimet në vitet e fundit, pjesëmarrja në AFP është e mbizotëruar nga meshkujt. Vetëm një e pesta e nxënësve në AFP janë femra.

Llojet kryesore të ofrimit/ programeve

Qendrat publike të formimit profesional ofrojnë kurse afatshkurtra dhe afatgjata, kryesisht për individët e papunë. Megjithatë, ato janë të hapura edhe për individët dhe të rinjtë. Gjithashtu, qendrat e formimit profesional kujdesen për grupet e rrezikuara, siç janë jetimët, personat me aftësi të kufizuara, emigrantët e kthyer, grupet rome dhe ish-të burgosurit.

E gjithë kurrikulat e AFP-së përfshijnë elementet e praktikës në punë. Por, deri para disa vitesh, zbatimi shpesh nuk ishte në nivelin që kërkohej. Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020 përcakton zhvillimin e elementeve të një “sistemi të dyfishtë”. Në vitin 2017, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve paraqiti një udhërrëfyes për të zgjeruar praktikat pranë kompanive për nxënësit e AFP-së. MFE dhe institucionet e AFP-së, të mbështetura nga donatorët, kanë dhënë një nxitje të re për organizimin e klasave praktike për nxënësit, duke përfshirë kur ato angazhohen në praktikë brenda kompanive. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” është e detyrueshme për nxënësit e AFP-së.

Kualifikimet kryesore sipas niveleve të KSNA

AFP-ja kryesisht ofrohet në shkollat e mesme (KSNA 3). Programet post-sekondare (KSNA 4) të AFP-së janë ende në fazën fillestare të zhvillimit. Gjatë vitit akademik 2017/18, më shumë se 20 000 nxënës u regjistruan në arsimin e mesëm profesional, që i korrespondon KSNA 3. Gjatë të

njëtit vit akademik, vetëm 1 800 nxënës u regjistruan në arsimin pas të mesëm, joterciar, që i korrespondon KSNA 4.

REGJISTRIMI NË PROGRAMET E AFP-SË SIPAS NIVELIT TË KUALIFIKIMEVE

	2012/13	2014/15	2007/18
Arsim profesional sekondar (të gjitha programet)	19 596	22 801	20 605
Arsimi AFP post-sekondar, joterciar	1 686	2 017	1 803

2. GARANTIMI I CILËSISË NË AFP

2.1 Pamje e përgjithshme

Garantimi i cilësisë (QA) shihet në terma të akreditimit të ofruesve të AFP-së. Akreditimi është një proces i jashtëm i vlerësimit të cilësisë që përcakton nëse një ofrues dhe programet/kualifikimet profesionale plotësojnë standardet e përcaktuara nga ligji. Procesi i akreditimit presupozon ekzistencën e një sistemi të garantimit të cilësisë, siç është vetë-vlerësimi. Megjithatë, akreditimi është ende në zhvillim dhe nuk është vënë ende në punë.

Sistemi i ri i akreditimeve përfshin një vetë-vlerësim të shkollës, që u prezantua për herë të parë në vitin 2018 dhe u implementua në mënyrë sistematike në vitin 2019.

2.2 Informacion i përgjithshëm mbi garantimin e cilësisë në nivel sistemi të AFP-së

Ligji “Mbi arsimin dhe formimin profesional” dhe ligji “Mbi Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve” përcaktojnë themelet për zhvillimin e një modeli akreditimi për sistemin shqiptar të AFP-së dhe shërbejnë si bazë ligjore për sistemin e garantimit të cilësisë.

Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve është përgjegjëse për menaxhimin e sistemit të akreditimit për ofruesit e AFP-së.

2.3 Garantimi i cilësisë në lidhje me fushat kyçe të AFP-së

Evidenca – statistikat dhe kërkim-zhvillimi

Është në zhvillim një sistem informacioni për tregun e punës. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe e Aftësive kryen analiza gjithëpërfshirëse të nevojave për aftësi në nivele kombëtare, rajonale në përputhje me një metodologji të provuar dhe të testuar dhe e përdor informacionin për të drejtuar personat vulnerabël drejt kurseve. Agjencia deri më tani ka kryer katër vlerësime të nevojave për aftësi. Ajo është gjithashtu përgjegjëse për studimet monitoruese që monitorojnë gjurmimin e të diplomuarve nga shkollat e AFP-së. Janë kryer analiza të tjera të njehershme të nevojave për aftësi të sponsorizuara nga donatorë, në nivele kombëtare/sectoriale dhe rajonale. Këto analiza përdoren për të planifikuar dhe drejtuar zhvillimin e sistemit të AFP-së, që përfshin bërjen e rregullimeve në rrjetin e ofruesit të AFP-së, identifikimin e profileve që ofrohen në secilin rajon dhe monitorimin e shifrave të regjistrimeve.

Tashmë, ekzistojnë elementet e sistemit të informacionit të menaxhimit (MIS) të AFP-së. Në të kaluarën, jo të gjithë ofruesit e AFP-së kanë dorëzuar të dhëna kyçe sipas kërkesës dhe MFE nuk ishte në gjendje të monitoronte dhe vlerësonte sistemin në një bazë të strukturuar. Por, kohët e fundit, situata është përmirësuar. Të dhënat janë tani të disponueshme, por sfida është si të përdoren siç duhet. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe e Aftësive po prezanton një sistem monitorimi që përfshin të diplomuarit e AFP-së. Është përfunduar një manual (viti 2016), stafi është trajnuar për sistemin e monitorimit dhe është duke u prezantuar raporti i parë kombëtar. Monitorimi është kryer nga institucionet e AFP-së me mbështetjen nga zyrat lokale të punësimit.

Garantimi i cilësisë dhe cikli i kualifikimeve

Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK) ka zhvilluar një kuadër metodologjik për hartimin e kurrikulës së AFP-së bazuar në përshkrimet e kualifikimeve dhe standardeve të profesioneve të AFP-së që mund të përshtaten sipas nevojave lokale. Vlerësimi i nxënësve të AFP-së fokusohet në testet me shkrim dhe ato praktike. Megjithatë, vlerësimi i përshtatshëm i aftësive praktike është i kufizuar dhe përfaqësuesit e industrisë rrallë janë të përfshirë. Certifikatat shpesh certifikojnë arritjen e aftësive të fituara. MFE njeh certifikatat që janë dhënë, por është i kufizuar monitorimi i standardeve të trajnimit dhe cilësisë së dhënies së trajnimit.

Pas një studimi të detajuar të tregut të punës, AKAFPK, përmes Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 514/2017, ka përditësuar Listën Kombëtare të Profesioneve të vitit 2009. AKAFPK zhvillon dhe përdor përshkrimet e profesioneve si një bazë për zhvillimin e përshkrimeve të kualifikimeve në listë. Lista gjithashtu përdoret si klasifikim për qëllime statistikore. Për shembull, shërbimet e punësimit përdorin listën për të kodifikuar aftësitë dhe kualifikimet e punëkërkuësve.

Miratimi i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK) konsiderohet kyç për reformimin e sistemeve të kualifikimeve dhe përmirësimin e cilësisë së rezultateve të tij. Në vitin 2018, ligji mbi KSHK-në u ndryshua për të përcaktuar nivelet dhe llojet e kualifikimeve në KSHK, strukturën e vet drejtuese dhe se si lidhet me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve. Tre aktet kryesore nënligjore u miratuan përmes Vendimeve të Këshillit të Ministrave në vitin 2019.

Garantimi i cilësisë dhe institucionet e ofrimit/ofruese të AFP-së

AKAFPK zhvillon programe formale të AFP-së dhe skeletkurrikula, të cilat më pas rregullohen dhe ndahen në plane mësimdhënëse nga shkollat profesionale. Qendrat e formimit profesional inkurajohen të zhvillojnë kurrikulat dhe materialet e tyre të kurseve në bazë të standardeve të kualifikimeve kombëtare dhe kanë marrë trajnim për ta bërë këtë. Gjatë viteve të fundit, nuk janë zhvilluar inspektime të AFP-së për shkak të mungesës së burimeve nga Inspektorati. Kriteret dhe proceset e reja të inspektimit nuk janë përcaktuar ende për AFP-në. Një sistem vetë-vlerësimi për shkollat u prezantua në një projekt pilot në vitin 2018 dhe më pas u implementua në vitin 2019.

Ofruesit privatë të AFP-së i nënshtrohen një procedure licencimi me Qendrën Kombëtare të Biznesit në bashkëpunim me MFE, por kriteret e cilësisë janë të paqarta dhe mungon ndjekja vijuese.

Studimi bazë i financuar nga donatorët i të gjithë ofruesve publikë të AFP-së (2014), që u zhvillua për të vlerësuar efikasitetin e tyre të brendshëm dhe efektshmërinë e jashtme, mbledhi të dhëna për 10 tregues kryesorë vlerësues. Vlerësimi konstatoi se shumica e ofruesve publikë të AFP-së i përkisnin kategorisë me performancë të ulët.

Garantimi i cilësisë dhe standardet e kualifikimeve të mësuesit/trajnesit të AFP-së dhe vazhdimi i zhvillimit profesional

Ekzistojnë standarde të përgjithshme të kompetencave dhe procedura standarde rekrutimi për të gjithë mësuesit e lëndëve të përgjithshme. Këto nuk janë specifike për AFP-në ose profile të ndryshme profesionale dhe menaxhohen në nivel qendror për të gjithë mësuesit e rinj përmes Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve. Mësuesit e AFP-së kryesisht kanë një diplomë të përgjithshme (ose të avancuar) në një fushë teknike, si p.sh. inxhinieri, dhe instruktorët (e orëve praktike), që nuk u kërkohet të kenë diplomë universitare. Kompetencat dhe performanca e mësuesve dhe instruktorëve nuk vlerësohen në mënyrë sistematike.

Sipas rregulloreve të reja, mësuesit dhe instruktorët e rinj të AFP-së duhet të kenë të paktën 2–3 vjet përvojë brenda industrisë. Gjatë viteve 2015–16, AKAFPK prezantoi një Program trajnimi 24 ditor “Bazat e Didaktikës”. Në fund të vitit 2019, rreth 70% e të gjithë mësuesve e kishin përfunduar programin.

Sipas një ankete të ETF mbi mësuesit dhe trajnuesit e AFP-së të zhvilluar në vitin 2018, një e treta e të anketuarve kishin 0 deri në 5 vjet përvojë pune dhe një e treta tjetër kishin 6 deri 15 vjet përvojë pune. Afërsisht 10% e mësuesve kishin më shumë se 25 vjet përvojë pune.

VKM 673 e datës 16 tetor 2019 për zbatimin e ligjit mbi AFP-në (15/2017) i cakton AKAFPK-së përgjegjësi formale për trajnimin e mësuesve të AFP-së dhe kërkon që institucionet e AFP-së të emërojnë koordinatorë të ZHVP-së. Ky ndryshim do të ndihmojë për vendosjen e ZHVP-së në AFP në një bazë më sistematike. AKAFPK aktualisht koordinon trajnimin e mësuesve dhe instruktorëve në Programin e lartpërmendur.

Mungojnë ende mekanizmat e mjaftueshëm të garantimit të cilësisë.

3. ZHVILLIMET, NEVOJAT EMERGJENTE DHE SFIDAT

Zhvillime të reja – në progres/në proces

Zhvillimet e mëposhtme të AFPT-së janë duke u zhvilluar ose planifikuar:

- Strategjia Kombëtare e rinovuar për Punësim dhe Aftësi 2019–2022 propozon përmirësimin e cilësisë dhe ndjeshmërisë ndaj gjinive në informacionet e tregut të punës, zhvillimin e instrumenteve për ndarjen e informacioneve për të dhënat e tregut të punës dhe përcaktimin e mekanizmave parashikues të aftësive sektoriale.
- Hapat e radhës propozojnë vazhdimin e zhvillimit të vazhduar profesional (ZHVP) të mësuesve të AFP-së duke përfshirë përdorimin e burimeve të Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve për të koordinuar ZHVP-në, miratimin e standardeve të kompetencave dhe rrugëve të karrierës për mësuesit dhe trajnuesit e AFP-së, si dhe përcaktimin e Njësive të Zhvillimit të Shkollave me përgjegjësi për VZHP-në brenda ofruesve të AFP-së.
- Përforsimi i zinxhirit të cilësisë së kualifikimeve, duke filluar nga nevojat e tregut të punës për dhënien e një kualifikimi, përfshin (i) ngritjen e komiteteve të aftësive të sektorëve me përfaqësim nga sektori privat për të identifikuar kualifikimet e përshtatura me nevojat e sektorit privat;

(ii) kualifikimet e brendshme dhe të jashtme me garantim të cilësisë në AFP; dhe (iii) theks më të fortë në modelet e AFP-së që integrojnë mësimin gjatë punës.

- Forcimi i mekanizmave të jashtëm të garantimit të sigurisë përfshin përcaktimin e modelit të akreditimit për ofruesit publikë dhe privatë dhe ngritjen e njësisë të inspektimit të ofruesve publikë të AFP-së.

Nevojat dhe sfidat

Për të përmirësuar garantimin e cilësisë në AFP, është e nevojshme që:

- të vazhdohet implementimi i kuadrit së përgjithshëm ligjor për AFP-në dhe KSHK-në, si dhe adresimi në mënyrë sistematike i sigurimit të cilësisë;
- të konsolidohet struktura institucionale për sigurimin e cilësisë në AFP (ligji mbi AFP-në nr. 15/2017) duke u siguruar që të vihen në dispozicion si burime njerëzore ashtu edhe burime financiare për përmbushjen e përgjegjësiave përkatëse;
- të konsiderohet krijimi i një sistemi të menaxhimit të informacionit të tregut të punës për të përmirësuar rëndësinë e tregut të punës dhe një sistem të menaxhimit të informacionit të AFP për të mbështetur monitorimin e përgjithshëm të AFP-së në sistem dhe në nivelin e ofruesve;
- të vazhdohet zhvillimi dhe implementimi KSHK-së, duke përfshirë mekanizmat e garantimit të cilësisë;
- të përgatiten dhe të aftësohen mësues dhe trajnues të AFP-së brenda kuadrit të garantimit të cilësisë;
- të përmirësohen mekanizmat për monitorimin e jashtëm dhe vlerësimin e ofruesve dhe ofrimit të AFP-së;
- të përmirësohet kapaciteti i ofruesve të AFP-së për vetë-vlerësim dhe garantim të përgjithshëm të sigurisë.

4. SHEMBULL I PRAKTIKAVE TË MIRA

Gjatë vitit 2017, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, me mbështetjen e programit të OKB-së për Zhvillimin e Aftësive për Punësim (SD4E), zhvilloi një paketë rregulluese për Vetë-vlerësimin e ofruesve të AFP-së që po u lancua si projekt pilot në Qendrën Multifunkcionale të Elbasanit me mbështetjen e IPA 2013. Tashmë, procesi i vetëvlerësimit po zbatohet prej 2 vitesh në sistem. Në vijim zhvillimi i kapaciteteve në AKAFPK dhe ofruesit e AFP-së si dhe zhvillimi i nje infrastrukture digjitale per zbatimin e procesit te vetëvlerësimit konsiderohen prioritetet,. Procesi i vetë-vlerësimit konsiderohet si hapi i parë drejt akreditimit të ofruesve të AFP-së.

Where to find out more

Website

www.etf.europa.eu

ETF Open Space

<https://openspace.etf.europa.eu>

Twitter

[@etfeuropa](https://twitter.com/etfeuropa)

Facebook

facebook.com/etfeuropa

YouTube

www.youtube.com/user/etfeuropa

Instagram

instagram.com/etfeuropa/

LinkedIn

linkedin.com/company/european-training-foundation

E-mail

info@etf.europa.eu



European Training Foundation

